



# FLETORJA ZYRTARE

E

## REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 44

2001

Gusht

### P Ë R M B A J T J A

Vendim i KM nr. 486, datë 14.8.2001	Për disa ndryshime në vendimin nr.427, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr.60, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve”.....	1383
Vendim i KM nr. 488, datë 14.8.2001	Për lejinin e Bankës së Kursimeve sh.a. të bëjë rivlerësimin e pasurive të paluajtshme të saj.....	1383
Vendim i KM nr. 491, datë 14.8.2001	Për pjesëmarrjen me kontratë menaxhimi të sektorit privat në Shoqërinë Anonime të Ujësjellës-Kanalizimeve të Bashkisë së Kavajës.....	1384
Vendim i KM nr. 494, datë 14.8.2001	Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike.....	1384
Vendim i KM nr. 495, datë 14.8.2001	Për trajtimin e punonjësve që dalin të papunë nga procesi i ristrukturimit të Albtelecom, sh.a.- së.....	1386

Vendim i KM nr. 497, datë 14.8.2001	Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Pajisjeve nën Presion.....	1387
Vendim i KM nr. 500, datë 14.8.2001	Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore.....	1387
Vendim i KM nr. 505, datë 14.8.2001	Për një ndryshim në vendimin nr. 335, datë 2.9.1997, të Këshillit të Ministrave “Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit” .....	1393
Vendim i KM nr.506, datë 14.8.2001	Për miratimin e kuotës së pranimit në Akademinë e Policisë “Arben Zylyftari” në vitin shkollor 2001-2002, në sistemin me shkëputje nga puna.....	1394
Vendim i K.K.R.T	Për dhënie licence .....	1394

**V E N D I M**  
**Nr. 486, datë 14.8.2001**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.427, DATË 11.6.2001 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.60, DATË 27.2.1992 TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESA MBI PAGË  
TË USHTARAKËVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës e të neneve 2 dhe 6 të ligjit nr. 8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Në vendimin nr.427, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave bëhen ndryshimet si më poshtë vijojnë:

a) Në shkronjën “b” të pikës 1, paga e ushtarëve të shërbimit të detyrueshëm dhe të studentëve ushtarakë të jetë deri 1080 lekë në muaj.

b) Në shkronjën “c” të pikës 1, paga për ushtarin rezervist të jetë deri 756 lekë në ditë. Brenda këtij niveli, Ministria e Mbrojtjes të caktojë pagën për çdo rast, në varësi me vështirësinë e detyrës, me llojin e armës e të shërbimit.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2001, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.7.2001.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr. 488, datë 14.8.2001**

**PËR LEJIMIN E BANKËS SË KURSIMEVE SH.A. TË BËJË RIVLERËSIMIN E  
PASURIVE TË PALUAJTSHME TË SAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c” të nenit 70 të ligjit nr.7661, datë 19.1.1993 “Për kontabilitetin”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Lejimin e Bankës së Kursimeve sh.a. të bëjë rivlerësimin e pasurive të paluajtshme, që janë sot në shfrytëzim të saj, duke marrë parasysh proceset inflacioniste.

2. Përdorimin e njërës nga metodat IAS, të përcaktuara nga vetë Banka e Kursimeve sh.a. për këtë rivlerësim.

3. Diferencat e rezultateve nga rivlerësimi të kalojnë në llogarinë “Rezerva nga rivlerësimi”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr. 491, datë 14.8.2001**

**PËR PJESËMARRJEN ME KONTRATË MENAXHIMI TË SEKTORIT PRIVAT NË  
SHOQËRINË ANONIME TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE TË BASHKISË SË KAVAJËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3 të ligjit nr. 8103, datë 28.3.1996 “Për privatizimin e ndërmarrjeve të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të përdorura” dhe të nenit 5 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë“ me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e dhënies me koncesion të shoqërisë anonime të ujësjellës-kanalizimeve të Bashkisë së Kavajës, sipas formës “Kontratë e administrimit (menaxhimit)”.

Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punëve Publike të jenë organi i autorizuar shtetëror, për përgatitjen dhe realizimin e kontratës së koncesionit.

Procedura për përzgjedhjen e kontratës të jetë “Propozim i kërkuar”.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punëve Publike, që, në bashkëpunim me këshilluesin ndërkombëtar, të përgatisin kontratën e menaxhimit dhe të dokumenteve e të materialeve të nevojshme për përzgjedhjen e operatorit privat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr. 494, datë 14.8.2001**

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSPEKTORATIT TË PAJISJEVE DHE  
INSTALIMEVE ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr.8734, datë 1.2.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike”, të ligjit nr. 8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave”, të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit nr. 8718, datë 19.12.2000 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001” me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Inspektorati i Pajisjeve dhe Instalimeve (IPIE) është person juridik buxhetor, në varësi të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, i specializuar për mbikqyrjen e zbatimit të rregullave, që garantojnë sigurinë e punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike në veprimtarinë e personave juridikë dhe fizikë.

2. Inspektorati drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit. Kryeinspektori dhe inspektorët në qendër përbëjnë nivelin qendror të organizimit. Inspektorët e zonave, brenda juridiksionit të një qarku, përbëjnë nivelin vendor të organizimit dhe varen administrativisht nga kryeinspektori.

3. Inspektorë zone të jenë 14 veta të vendosur në këto prefektura: Tiranë, Bashkia e Tiranës, Durrës, Shkodër, Dibër, Korçë, Elbasan, Fier, Vlorë, Lezhë, Berat, Kukës dhe Gjirokastrë.

Ndarja në zona përfshin gjithë territorin e vendit sipas organizimit të bërë nga IPIE-ja.

4. Inspektorati e ka qendrën në Tiranë. Inspektorati në qendër plotësohet me mjedise nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit ndërsa inspektoratet e zonave plotësohen me mjedise pune sipas propozimeve të prefekturave, që mbulojnë zonat përkatëse.

5. Të drejtën e ushtrimit të kontrollit e kanë të gjithë inspektorët e IPIE-së, të cilët pajisen me dokument identifikimi nga sektori i sigurimit teknik të ministrisë.

IPIE-ja funksionon sipas rregullores së brendshme, të miratuar nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

6. Për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, kryeinspektori mbledh “Komisionin e shqyrtimit të gjobave të IPIE-së”. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët propozohen nga IPIE-ja dhe miratohen nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit. Rregullat e funksionimit të komisionit përcaktohen në rregulloren e brendshme të IPIE-së.

7. Ndaj masave të marra nga inspektorët bëhet ankimi me shkrim te kryeinspektori i IPIE-së, brenda 5 ditëve nga data e mbajtjes së procesverbalit. Vendimi i këtij të fundit duhet të jepet brenda një afati 10-ditor nga data e mbërritjes së ankesës në IPIE.

8. Në vendimin nr.75, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për numrin e punonjësve të institucioneve buxhetore për vitin 2001” të parashikohet shtesa e numrit të punonjësve prej 20 vetësh. Struktura organizative e Inspektoratit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike është sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore” shtohet lidhja II-27 “Niveli i pagave të punonjësve të Inspektoratit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

10. Efekti ekonomik i kalimit të IPIE-së në varësi të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, për periudhën qershor-dhjetor të vitit 2001, prej 10 180 517 lekësh, të përballohet nga të ardhurat që krijon Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, përjashtimisht nga vendimi nr.424, datë 9.7.1998 i Këshillit të Ministrave “Për të ardhurat që krijojnë institucionet buxhetore”.

11. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

12. Vendimi nr.148, datë 9.12.1967 i Këshillit të Ministrave “Për Inspektoratin shtetëror të sigurimit teknik për instalimet dhe pajisjet elektrike”, ndryshuar me vendimin nr.108, datë 25.3.1980 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**PASQYRA NR.1**  
**STRUKTURA ORGANIZATIVE E INSPEKTORATIT TË PAJISJEVE DHE INSTALIMEVE**  
**ELEKTRIKE**

Nr	Emërtimi	Profesioni	Numri
I	Kryeinspektor	Ing.elektrik	1
II	Grupi i inspektimit		
1	Zv.kryeinspektor dhe inspektor në qendër	Ing.elektrik	1
2	Inspektor në qendër	Ing.elektrik	2
3	Inspektor zone	Ing.elektrik	14
III	Dega ekonomike		
1	Ekonomist, financiar	Ekonomist, financier	1
2	Shofer	Shofer	1

LIDHJA II-27  
NIVELI I PAGAVE TË PUNONJËSVE TË INSPEKTORATIT TË PAJISJEVE DHE  
INSTALIMEVE ELEKTRIKE

Nr.EmërtimiKlasifikimi  
1Kryeinspektor i IPEB3  
2Zv.kryeinspektor dhe inspektor në qendër B5  
3Inspektor në zonëB5

Shënim: Për punonjësit e tjerë të zbatohen pagat sipas lidhjes II-5 “Niveli i pagës për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.726, datë 21.12.2000.

**V E N D I M**  
**Nr. 495, datë 14.8.2001**

**PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE QË DALIN TË PAPUNË NGA PROCESI I  
RISTRUKTURIMIT TË ALBTELECOM, SH.A. - SË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3 të ligjit nr. 8810, datë 17.5.2001 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Albtelecom”, sh.a.”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Punonjësit, që dalin të papunë nga procesi i ristrukturimit të “Albtelecom”, sh.a.- së, në periudhën nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi deri në çastin e privatizimit të shoqërisë, përfitojnë kompensim, për një periudhë 2-vjeçare, në masën 100 për qind të pagës bazë të pozicionit (në punë), në çastin e largimit të tyre.

2. Për efekt pensioni, periudha e mësipërme e kompensimit të njihet si vjetërsi në punë dhe të shënohet e tillë në librezën e punës.

3. Përfitojnë nga ky vendim të gjithë punonjësit e sotëm të “Albtelecom”, sh.a.-së, që kanë punuar në këtë shoqëri për një periudhë jo më pak se 2 vjet.

4. Të drejtën e kompensimit, në përputhje me këtë vendim, e përfitojnë ata punonjës të cilët nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike në formën e punësimit apo të vetëpunësimit. Në rast të kundërt, u ndërpritet kompensimi që përfitojnë sipas këtij vendimi.

5. Të gjitha fondet e nevojshme për kompensimin e këtyre punonjësve dhe detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore të mbulohen nga të ardhurat e Albtelecom, sh.a.-së, përpara përfundimit të procesit të privatizimit. Pas përfundimit të proesit të privatizimit këto fonde të mbulohen nga të ardhurat e privatizimit.

6. Paga e punonjësve që përfitojnë kompensim dhe pagesa e detyrimeve për sigurimin shoqëror e shëndetësor të tyre të bëhet çdo muaj, nga zyrat e punësimit në rrethet përkatëse.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Financave për nxjerrjen e udhëzimit përkatës dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Illir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr. 497, datë 14.8.2001**

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSPEKTORATIT TË PAJISJEVE NËN  
PRESION**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr. 8739, datë 12.2.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve nën presion”, të ligjit nr. 8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave”, të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit nr. 8718, datë 19.12.2000 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Inspektorati i Pajisjeve nën Presion (IPNP) është person juridik, buxhetor në varësi të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, i specializuar për mbikqyrjen e zbatimit të rregullave që garantojnë sigurinë e punës të pajisjeve nën presion, në veprimtarinë e personave juridikë dhe fizikë.

2. IPNP-ja drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit. Kryeinspektori dhe inspektorët e qendrës përbëjnë nivelin qendror të organizimit, ndërsa inspektorët e zonave brenda juridiksionit të një qarku përbëjnë nivelin vendor të organizimit dhe varen administrativisht nga kryeinspektori.

3. Inspektorë zone të jenë 10 veta, të vendosur në këto prefektura: Tiranë, Durrës, Shkodër, Dibër, Korçë, Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastrë dhe Bashkia e Ballshit. Ndarja në zona përfshin gjithë territorin e vendit sipas organizimit të bërë nga IPNP-ja, në përputhje me numrin dhe madhësinë e pajisjeve nën presion.

4. IPNP-ja e ka qendrën në Tiranë. Plotësimi me mjedise pune i inspektoratit në qendër bëhet nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, ndërsa i inspektorateve të zonave bëhet sipas propozimeve të prefekturave që mbulojnë zonat.

IPNP-ja funksionon sipas rregullores së brendshme të miratuar nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

5. Të drejtën e ushtrimit të kontrollit e kanë të gjithë inspektorët e IPNP-së, të cilët janë të pajisur me dokument identifikimi nga sektori i sigurimit teknik të ministrisë.

6. Për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative kryeinspektori mbledh “Komisionin e shqyrtimit të gjobave të IPNP-së”, i cili përbëhet nga 5 anëtarë.

Anëtarët e komisionit të shqyrtimit të gjobave të inspektoratit propozohen nga IPNP-ja dhe miratohen nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit. Rregullat e funksionimit të komisionit përcaktohen në rregulloren e brendshme të IPNP-së.

7. Ndaj masave të marra nga inspektorët bëhet ankimi me shkrim te kryeinspektori i IPNP-së, brenda 5 ditëve nga data e mbajtjes së procesverbalit. Vendimi i këtij të fundit duhet të jepet brenda një afati 10 ditor nga data e mbërritjes së ankesës në IPNP.

8. Në vendimin nr.75, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për numrin e punonjësve të institucioneve buxhetore për vitin 2001” të parashikohet shtesa e numrit të punonjësve prej 16 vetash. Struktura organizative e IPNP-së është sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Në vendimin nr. 726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore” shtohet lidhja II-26 “Niveli i pagave të punonjësve të Inspektoratit të Pajisjeve nën Presion” që i bashkëlidhet këtij vendimi.

10. Efekti ekonomik i kalimit të IPNP-së në varësi të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, për periudhën qershor-dhjetor të vitit 2001, prej 7 766 566 lekësh, të përballohet nga të ardhurat që krijon Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, përjashtimisht nga vendimi nr.424, datë 9.7.1998 i Këshillit të Ministrave “Për të ardhurat që krijojnë institucionet buxhetore”.

11. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

12. Vendimi nr.140, datë 31.3.1980 i Këshillit të Ministrave “Për Inspektoratin e Pajisjeve nën Presion”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**PASQYRA NR.1**  
**STRUKTURA ORGANIZATIVE E INSPEKTORATIT TË PAJISJEVE NËN PRESION**

Nr	Emërtimi	Profesioni	Numri
I	Kryeinspektor	Ing.mekanik	1
II	Grupi i inspektimit		
1	Zv.kryeinspektor dhe inspektor në qendër	Ing.mekanik	1
2	Inspektor në qendër	Ing.mekanik	1
		Ing.kimist	1
3	Inspektor zone	Ing.mekanik.teknik	10
III	Dega ekonomike		
1	Ekonomist, financiar	Ekonomist, financier	1
2	Shofer	Shofer	1

**LIDHJA II- 26**  
**NIVELI I PAGAVE TË PUNONJËSVE TË INSPEKTORATIT TË PAJISJEVE NËN PRESION**

Nr.Emërtimi    Klasifikimi

- 1Kryeinspektor i IPNPB3
- 2Zv.kryeinspektor dhe inspektor në qendër B5
- 3Inspektor në qendër B5
- 4Inspektor në zonëB5

Shënim: Për punonjësit e tjerë të zbatohen pagat sipas lidhjes II-5 “Niveli i pagës për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 726, datë 21.12.2000.

**V E N D I M**  
**Nr. 500, datë 14.8.2001**

**PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE DHE**  
**TRANSFERIMIN E PRONAVE NË NJËSITË E QEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të nenit 21 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit nr. 8718, datë 19.12.2000 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**



1. Krijimin e Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike (AITPP), e cila do të jetë në varësi të drejtpërdrejtë të Ministrit të Pushtetit Lokal, për kryerjen e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore dhe për hartimin e procedurave për transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të këtij vendimi. Kjo Agjenci do të ketë 20 punonjës për vitin 2001 dhe 45 punonjës për vitin 2002 e në vazhdim, deri në përfundimin e procesit të inventarizimit dhe transferimit të pronave njësite të qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të ligjeve nr. 8743 dhe nr. 8744, datë 22.2.2001.

Struktura organizative e AITPP-së miratohet nga Kryeministri me propozimin e Ministrit të Pushtetit Lokal.

Kryetari i AITPP-së emërohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Lokal.

Krijimi i AITPP-së ka karakter të përkohshëm.

Në çdo qark krijohen degët e Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike në qark (AITPPQ), të cilat janë në varësi të kryetarit të AITPP-së. Këto degë kanë për detyrë të ndjekin, lehtësojnë dhe bashkërendojnë procesin e inventarizimit të pronës publike, shtetërore nga institucionet e përfshira në këtë proces në territorin e qarkut, si dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore.

Punonjësit e AITPP-së dhe të degëve të saj nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe merren në punë në përputhje me legjislacionin e punës në fuqi.

Në lidhjen I, në klasifikimin “B1” të vendimit nr. 424, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave shtohet funksioni “Kryetari i Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike”, në Ministrinë e Pushtetit Lokal.

2. Institucionet e administratës qendrore, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, njësitë e qeverisjes vendore dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme janë palë pjesëmarrëse aktive në këtë proces dhe janë të detyruara të përgatisin dhe të vënë në dispozicion të AITPP-së të gjithë dokumentacionin përkatës të nevojshëm për realizimin e këtij procesi, sipas përcaktimeve në këtë vendim.

3. AITPP-ja, në bashkëpunim me Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP), harton brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi një plan të hollësishëm për të gjitha masat dhe veprimet që duhen ndërmarrë për inventarizimin dhe transferimin e pronës. Ky plan duhet të përcaktojë mënyrën e përgatitjes së dokumentacionit, atë të këmbimit të informacionit, rregullat për administrimin e informacionit dhe formularët standard, me udhëzimet përkatëse për plotësimin e tyre, që do të përdoren në të gjitha hapat e procesit.

4. AITPP-ja u dërgon, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të gjitha institucioneve të përcaktuara sipas pikës 2 të këtij vendimi, të gjitha matarialet dhe formularët e nevojshëm për inventarizimin dhe transferimin e pronave.

AITPP-ja nxjerr udhëzime për çështje të veçanta, në zbatim të ligjeve nr. 8743 dhe 8744, datë 22.2.2001.

5. ZQRPP-ja vë në dispozicion të AITPP-së, brenda katër muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, listën e zonave kadastrale në Republikën e Shqipërisë.

AITPP-ja bën grupimin e tyre sipas njësite të qeverisjes vendore.

6. Për të gjitha zonat kadastrale, ku regjistrimi fillestar i pronës ka përfunduar ose është në proces, inventarizimi i pronës publike, shtetërore mbështetet tek informacioni i marrë nga ZRPP-ja.

Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme përgatit listat e pronave shtetërore, të regjistruara ose në proces, për çdo zonë kadastrale, posaçërisht për miratimin e inventarit nga Këshilli i Ministrave. Përmbajtja dhe formati i këtyre listave verifikuese hartohet bashkërisht nga AITPP-ja dhe ZQRPP-ja. Këto lista duhet të sqarojnë për çdo pronë: indeksin e hartës, numrin e pasurisë, adresën, llojin e pronës, sipërfaqen e pronës dhe çdo specifikim tjetër, të nevojshëm, që ndodhet në ZRPP. ZRPP-të përgatisin dhe vënë në dispozicion të AITPP-së hartën treguese të pronave, sipas listës, për çdo zonë kadastrale, që është përpunuar deri në çastin e dhënies së informacionit. Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në rrethe, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, dërgojnë në degët e AITPPQ-ve të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në këtë pikë.

Për ato zona kadastrale ku dokumentacioni i regjistrimit të pronës marrë nga ZRPP-ja është i plotë, ai shërben drejtpërdrejt për listën përfundimtare të inventarit. Ministria e Pushtetit Lokal e paraqet këtë listë për miratim në Këshillin e Ministrave.

Për zonat ku regjistrimi i pronave nuk ka filluar ende, inventarizimi i pronës publike të mbështetet në burimet e informacionit të vetë institucionit të përfshirë në procesin inventarizues dhe në verifikimet në terren, aty ku është e nevojshme.

7. ZRPP-të e rretheve janë të detyruara të lejojnë përfaqësuesit e autorizuar të organeve të pushtetit qendror dhe të organeve të qeverisjes vendore të shfrytëzojnë, për efekt të zbatimit të këtij vendimi, “Librin e ngastrave” dhe kartelat e regjistrimit të pasurive.

8. AITPP-ja dërgon në institucionet e administratës qendrore dhe në njësitë e qeverisjes vendore, të përcaktuara sipas pikës 2 të këtij vendimi, të gjithë dokumentacionin e marrë nga ZRPP-të dhe formularët, shoqëruar me udhëzimet, jo më vonë se shtatë muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit. Dokumentacioni që u dërgohet çdo njësie të qeverisjes vendore përmban të gjitha pronat shtetërore, të regjistruara dhe ato në proces, që u përgjigjen zonave kadastrale të territorit që ajo mbulon, ndërsa listat e verifikimit, që u dërgohen institucioneve të pushtetit qendror, përfshijnë të gjitha pronat në shkallë vendi.

9. Çdo institucion i pushtetit qendror dhe çdo njësi e qeverisjes vendore, në strukturën e administratës së vet, krijon, me miratimin e këshillit përkatës, një njësi të veçantë (zyrë ose sektor) me karakter të përkohshëm. Emërimi i personelit bëhet nga titullari i institucionit apo nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore. Seksioni apo zyra funksionon vetëm për kohën dhe problematikën e parashikuar në këtë vendim dhe përgjigjet përpara titullarit apo personit të autorizuar nga ai.

10. Institucionet e pushtetit qendror dhe organet e qeverisjes vendore, brenda tre muajve pas marrjes së dokumentacionit nga AITPP-ja, përgatisin dhe dërgojnë në DPP inventarin e pronave shtetërore nën përgjegjësitë e tyre administrative, në përputhje me formularët dhe udhëzimet e dërguara nga AITPP-ja.

11. Gjatë procesit të inventarizimit, AITPP-ja dhe degët e AITPPQ-ve mbajnë lidhje të vazhdueshme me të gjitha institucionet e pushtetit qendror dhe njësitë e qeverisjes vendore dhe, së bashku me Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në rrethe, sigurojnë asistencë këshilluese për institucionet e pushtetit qendror dhe për organet e qeverisjes vendore, gjatë kohës që ato përgatisin informacionin e inventarizimit.

12. AITPP-ja, në mbështetje të informacionit të marrë, përgatit listën e inventarit dhe Ministria e Pushtetit Lokal ia paraqet për miratim Këshillit të Ministrave të tërën ose pjesë-pjesë, jo më vonë se 11 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit. Këshilli i Ministrave miraton listën e inventarit, jo më vonë se 12 muaj nga data e hyrjes në fuqi e ligjit.

13. Të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, dërgojnë në Ministrinë e Pushtetit Lokal, për ndërtesat administrative dhe mjediset e tjera, që i administrojnë vetë dhe ku kryejnë veprimtarinë e tyre, një listë të veçantë, formati i së cilës hartohet po nga kjo Ministri. Lista shoqërohet me planvendosjen dhe planimetrinë e objektit (ose objekteve). Ministria e Pushtetit Lokal, një muaj pas marrjes së listave të veçanta nga njësitë e qeverisjes vendore, nëpërmjet AITPP-së, bën verifikimet e nevojshme dhe njofton këto njësi të fillojnë procedurat e regjistrimit të këtyre pronave, në emër të tyre, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në rrethe. Në rast se organi i qeverisjes vendore, një muaj pas dërgimit të dokumentacionit në Ministrinë e Pushtetit Lokal, nuk ka marrë njoftimin e përcaktuar në këtë pikë, fillon procedurat e regjistrimit drejtpërdrejtë në zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme.

Regjistrimi bëhet duke paraqitur në ZRPP-të e rretheve:

- a) planvendosjen e objektit;
- b) planimetrinë e objektit;
- c) urdhrin e Ministrit të Pushtetit Lokal për regjistrimin e pasurisë.

Pas regjistrimit në pronësi të ndërtesave administrative dhe të mjedisëve përkatëse, bashkitë ose komunat kanë të drejtë dhe janë të detyruara të vendosin çdo aset në librin e llogarive, sipas rregullave kontabël, që zbatohen për qeverisjen vendore. Mbajtësi i mëparshëm i kësaj prone, nëse është i ndryshëm nga pronari i ri, duhet që, njëkohësisht, ta heqë këtë aset nga librat e tij kontabël.

Ky transferim kontabël i asetit do të dokumentohet në aktin e veçantë të transferimit kontabël, të nënshkruar nga të dyja palët.

14. Brenda 13 muajve pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit, njësitë e qeverisjes vendore dërgojnë në degët e AITPPQ-ve dhe këto të fundit në AITPP, listën e pronave publike, që ato kërkojnë t'u transferohen në pronësi, përveç ndërtesave administrative, të cilat trajtohen sipas pikës 13 të këtij vendimi. Brenda këtij afati, institucionet e pushtetit qendror dërgojnë në AITPP listën e pronave publike, që ato kërkojnë t'u mbeten në administrim. Këto lista hartohen në formatet e caktuara me udhëzimet e përgatitura nga AITPP-ja.

Për zonat kadastrale ku ka përfunduar procesi i regjistrimit të pasurive të paluajtshme, shtetërore ose për zonat ku regjistrimi i pronave është në proces nga zyrat e regjistrimit të pronave të paluajtshme dhe ka dokumentacion të plotë për to, sipas materialeve dhe formularëve që shpërndan AITPP-ja, sipas pikave 4 e 6 të këtij vendimi, njësitë e qeverisjes vendore paraqesin kërkesën për transferim të pronave, njëkohësisht me dërgimin e listës së inventarit.

15. Ministria e Pushtetit Lokal, nëpërmjet AITPP-së, përcakton tipin e pronës që do t'u transferohet njësitë të qeverisjes vendore si tërësi, ku përfshihen rrugët vendore, trotuaret, sistemet vendore të ujësjellës-kanalizimeve, etj. pa vënë në listë pronat e këtyre tipave, në bazë parcele, sipas numrit të pasurisë edhe të elementëve të tjerë të saj.

16. Ministria e Pushtetit Lokal, brenda 11 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit dhe pas këshillimeve me shoqatat e të zgjedhurve vendorë, paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave projektvendimin, i cili përcakton kufizimet për pronat e transferuara në pronësi dhe në përdorim të njësitë të qeverisjes vendore. Kushtet dhe kufizimet duhet të jenë për kategori pronash dhe jo për objekte të veçanta.

17. Ministria e Pushtetit Lokal, në bazë të listës së inventarizimit dhe të kërkesave të njësitë të qeverisjes vendore dhe pasi shqyrton kërkesat e bëra nga institucionet qendrore, sipas pikës 14 të këtij vendimi, së bashku me vendimet e Ministrisë së Pushtetit Lokal për tipat e pronave të transferuara, si tërësi, paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave jo më vonë se 19 muaj nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, listat, e pjesshme apo tërësore, paraprake, të pronave që rekomandohen për transferim në pronësi dhe në përdorim të çdo njësitë të qeverisjes vendore, së bashku me kushtet dhe kufizimet e pronave, të formuluar nga Këshilli i Ministrave. AITPP-ja ua dërgon listat paraprake të miratuara nga Këshilli i Ministrave, njësitë të qeverisjes vendore dhe i shpall ato publikisht. Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara t'i shpallin listat paraprake në vendet publike dhe mundësisht në media, jo më vonë se 10 ditë nga marrja e tyre prej AITPP-së, për një afat kohor jo më pak se 1 muaj. Ndërtesat dhe mjediset administrative nuk përfshihen në këto lista.

18. Me marrjen e listave paraprake të këtyre pronave për transferim në njësitë e qeverisjes vendore, brenda 3 muajve, i paraqesin AITPP-së vërejtjet që kanë për pronat e miratuara në listat paraprake.

Vërejtjet mund të kenë lidhje me:

- a) pretendimet konfliktuale ndërmjet dy ose më shumë njësitë të qeverisjes vendore;
- b) vërejtje të njësitë të qeverisjes vendore për pronat e përfshira në listat paraprake;
- c) vërejtje të njësitë të qeverisjes vendore për kushtet dhe kufizimet e propozuara.

Për shqyrtimin e këtyre vërejtjeve krijohet një bord këshillimor, nën drejtimin e Ministrit të Pushtetit Lokal, me dy përfaqësues nga Ministria e Financave, dy nga Ministria e Pushtetit Lokal, dy nga shoqatat e të zgjedhurve vendorë dhe një nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

19. Ministria e Pushtetit Lokal, në bazë të informacionit përfundimtar dhe pas rekomandimeve të bordit këshillimor, por jo më vonë se 23 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit, i paraqet Këshillit të Ministrave për miratim listën përfundimtare, të pjesshme ose tërësore, të pronave që u transferohen njësitë të qeverisjes vendore, përfshi dhe kushtet apo kufizimet që u vihen, përkatësisht, për secilën pronë.

20. Ministria e Pushtetit Lokal, nëpërmjet AITPP-së, u dërgon njësitë të qeverisjes vendore përkatëse dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme në rreth listat përfundimtare të

transferimit të pronave, bashkë me planvendosjet e tyre. Regjistrimi i tyre bëhet në përputhje me ligjin përkatës. Kështu, për pronat që më parë kanë qenë të regjistruara si pronë shtetërore do të bëhet ndryshimi i pronarit. Për pronat që nuk janë regjistruar ende bëhet regjistrimi sipas procedurave standarde të regjistrimit, nën emrin e komunës, bashkisë apo qarkut.

21. Që nga çasti i marrjes së listës përfundimtare të pronës që do të transferohet, çdo njësi e qeverisjes vendore është përgjegjëse për;

a) mbajtjen e listës së inventarizimit të këtyre pronave;

b) azhurnimin në vazhdimësi të listës së inventarit pas regjistrimit, sa herë që merren prona të reja, jepen ose shiten ose shfaqen interesa të palëve të treta, siç është dhënia me qira apo hipotekimi.

22. Pas miratimit të listës së pronave të transferuara dhe regjistrimit të këtyre pronave në emër të njësisë të qeverisjes vendore, këto të fundit, si edhe pronari i mëparshëm reflektojnë çdo pronë si aset në bilancet e veta, sipas ligjit "Për kontabilitetin".

23. Ministria e Pushtetit Lokal i paraqet për miratim Këshillit të Ministrave, jo më vonë se 24 muaj nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, listat e pronave që mbeten në pronësi të pushtetit qendror, në bazë të të cilave do të caktohen përgjegjësitë administrative të institucioneve të ndryshme të pushtetit qendror.

24. Pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, sipas pikës 23, listat përfundimtare të pronave të zotëruara nga pushtetit qendror, me përgjegjësitë administrative, u dërgohen institucioneve përkatëse të pushtetit qendror dhe Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Për pronat të regjistruara "pronë shtetërore" shënohet emri i institucionit të pushtetit qendror, i cili e ka në administrim. Për pronat që ende nuk janë regjistruar bëhet regjistrimi sipas procedurave të regjistrimit të pasurive dhe shënohet institucioni përgjegjës administrativ. Pronat që mbeten në pronësi të pushtetit qendror do të regjistrohen në emër të Republikës së Shqipërisë.

25. Derisa Këshilli i Ministrave të miratojë listën e pronave që do t'u transferohen njësisë të qeverisjes vendore dhe listat e pronave që i mbeten në pronësi pushtetit qendror, me përgjegjësit e caktuar administrativ, institucionet e pushtetit qendror, të cilat kanë qenë deri në këto çaste, përgjegjës për mirëmbajtjen dhe riparimin e pronës publike e ruajnë këtë përgjegjësi.

26. Institucionet e pushtetit qendror janë përgjegjës për:

- mbajtjen e listave të inventarizimit, me përgjegjësi të përcaktuar menaxhimi, derisa të bëhet verifikimi i pronësisë publike të këtyre pronave dhe regjistrimi i tyre;

- azhurnimin e listave të inventarizimit pas regjistrimit, kur prona të reja jepen në përgjegjësi administrative ose disa prona të tjera hiqen.

27. Rregullimet kontabl për pronat që do të mbeten në pronësi të qeverisë qendrore do të trajtohen me një vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

28. Për përballimin e procesit të inventarizimit dhe të transferimit të pronave shtetërore në njësitë e qeverisjes vendore, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, brenda një muaji nga dalja e këtij vendimi, paraqet në Ministrinë e Pushtetit Lokal kërkesën për fondet përkatëse.

29. Ministrisë së Pushtetit Lokal, në buxhetin e miratuar për vitin 2001, i shtohen 7 422 000 (shtatë milionë e katërqind e njëzet e dy mijë) lekë për ngritjen e Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, të cilat do të përdoren si më poshtë vijon:

-1 619 000 (një milion e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë mijë) lekë për pagat;

526 000 (pesëqind e njëzet e gjashtë mijë) lekë për sigurimet shoqërore;

27 000 (njëzet e shtatë mijë) lekë për sigurimet shëndetësore;

1 250 000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë për shpenzime operative;

4 000 000 (katër milionë) lekë për investime.

Ministri i Pushtetit Lokal, brenda 1 muaji nga dalja e këtij vendimi, paraqet në Këshillin e Ministrave kërkesën për fondet e nevojshme për realizimin e këtij procesi në tërësi dhe për vitin 2001 në veçanti, përfshirë shpenzimet për ZRPP-në, si dhe për ngritjen dhe funksionimin e zyrave, pranë institucioneve qendrore dhe njësisë të qeverisjes vendore. Parashikimi i fondeve për vitet

pasardhëse bëhet si zë më vete në buxhetin e Ministrisë së Pushtetit Lokal.

30. Ky fond prej 7 422 000 lekësh të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

31. AITPP-ja ka autoritetin për të kërkuar nga institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore respektimin e afateve dhe të procedurave të përcaktuara në këtë vendim, si dhe të vendosë detyrime kohore për njësi të veçanta, për plotësimin e dokumentacionit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr. 505, datë 14.8.2001**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 335, DATË 2.9.1997, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË**  
**SHËRBIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 8668, datë 23.10.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I :**

Në vendimin nr. 335, datë 2.9.1997, të Këshillit të Ministrave:

a) Në pikën 3 të shtohen:

“-Avokati i Përgjithshëm i Shtetit;

-Bashkëshorti/bashkëshortja e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit”.

b) Në pikën 4 të shtohet:

“-Sekretari i Përgjithshëm i Avokaturës së Shtetit”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

**KRYEMINISTRI**  
**ILIR META**

**V E N D I M**  
**Nr.506, datë 14.8.2001**

**PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT NË AKADEMINË E POLICISË “ARBEN**  
**ZYLYFTARI” NË VITIN SHKOLLOR 2001-2002, NË SISTEMIN ME SHKËPUTJE NGA**  
**PUNA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31 të ligjit nr. 8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I :**

1. Kanë të drejtë të regjistrohen për konkurrim në Akademinë e Policisë “Arben Zylyftari” kandidatët që plotësojnë kriteret e pranimit në Policinë e Shtetit, të përcaktuara në nenin 16 të ligjit nr. 8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.

2.Kuotat e pranimeve të reja janë:

a) Kuota të lira 20

b) Kuotat e Kryeministrit 5

Kuotat e vëna në dispozicion të Kryeministrit u shpërndahen kandidatëve që kanë konkurruar dhe, nëse nuk plotësohen atëherë, në të njëjtën masë, u shtohen kuotave të lira.

3. Ngarkohet Ministria e Rendit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

**KRYEMINISTRI**

**Ilir Meta**

**V E N D I M**

**Nr.57, datë 17.8.2001**

**PËR DHËNIE LICENCE**

Për televizionin vendor privat “Kristal +”

Subjektit: Z.Thanas Kote

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**V E N D O S I:**

1. T’i japë subjektit, z.Thanas Kote licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca, bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:  
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 27.8.2001  
Doli nga shtypi më 29.8.2001

Tirazhi: 4100 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “At Gjergj Fishta” sh.p.k.  
Tiranë, 2001

Çmimi: 150 lekë